

**PROF. DR. MEHMET ÇELIKU – NJË JETË KUSHTUAR SHQIPES
DHE ARSIMIT TË LARTË (15.01.1936 -30.12.2020)**

Më 30 dhjetor 2020 u nda nga jeta profesori i mirënjohur, Mehmet Çeliku, një nga figurat më të rëndësishme të gjuhësisë shqiptare dhe të arsimit të lartë në vend. Ai ishte vazhdues i denjë i traditës elbasanase në gjuhësi e radhitet përkrah gjuhëtarëve më të njohur elbasanas, si Kristoforidhi, Xhuvani, Cipo, Domi, Haxhihasani, Dodbiba etj. për kontributin e tij cilësor në shkencë dhe vlerat intelektuale të përçuar ndër vite në breza të tërë studentësh.

Profesor Mehmet Çeliku u lind në Elbasan më 15 janar 1936, qytet ku mori mësimet e para dhe kreu arsimin e mesëm në Shkollën e mesme pedagogjike në vitet 1950-1954. Studimet e larta i kreu për gjuhë shqipe dhe letërsi në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në vitet 1954-1958. Pas mbarimit të studimeve emërohet në Institutin e Gjuhës dhe të Letërsisë si bashkëpunëtor shkencor në sektorin e gramatikës dhe dialektologjisë ku punoi për 15 vjet deri më 1973 kur transferohet, me kërkesë të tij, në Elbasan, në Institutin e Lartë Pedagogjik “Aleksandër Xhuvani”, të sapongritur (1971), dhe merr drejtimin e katedrës së gjuhës, letërsisë dhe gjuhëve të huaja, të cilën e drejton për 19 vite deri më 1992, vit në të cilin emërohet Rektor i Universitetit të Elbasanit, post të cilin e mban deri më 1996. Në zgjedhjet e marsit të vitit 1992 zgjidhet deputet, i propozuar nga shoqëria civile, nën siglën e Partisë Republikane.

Në karrierën e tij të gjatë akademike ka kaluar nëpër të gjitha shkallët e kualifikimit. Më 1980 Çeliku mbrojti gradën “Kandidat i Shkencave” me disertacionin me temë “Gegërishtja jugperëndimore”, më 1984 mori titullin Docent, ndërsa më 1990 mori gradën “Doktor i Shkencave”, me disertacionin me temë “Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe” e më 1994 mori titullin Profesor. Gjithashtu është nderuar me titujt “Punonjës i shquar i shkencës dhe i teknikës” (1987), “Mësues i Popullit” (1993) dhe “Qytetar nderi” i Elbasanit (2006).

Në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” punoi për 45 vjet, nga 1973 deri në vitin 2018, ku zhvilloi si titullar disa lëndë, si: morfologji, sintaksë, dialektologji, shqipja standarde, metodologji e kërkimit shkencor dhe tri kurse speciale: probleme të morfologjisë, çështje të normës gramatikore dhe format e pashtjelluara të foljes. Ai ka zhvilluar leksione edhe në universitete të tjera, si në Universitetin e Tiranës, të Gjirokastrës, Tetovës etj. Gjatë kësaj kohe ka udhëhequr disa disertacione për marrjen e gradës shkencore “doktor”, si edhe tema universitare në nivelin master dhe bachelor. Kur ka qenë

bashkëpunëtor shkencor në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë, Çeliku është angazhuar edhe si pedagog i jashtëm në Institutin Dyvjeçar dhe në Universitetin e Tiranës, ku ka lekturuar morfologjinë e gjuhës shqipe dhe kurse speciale. Gjithashtu është angazhuar për disa vite si lektor i ftuar për kurset pasuniversitare në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe Fakultetin e Historisë e Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Në vite ka asistuar në provime në UT, UE dhe në filialet universitare të Korçës, Beratit etj., duke marrë në provime rreth 25000 studentë.

Karriera e gjatë mësimdhënëse është shoqëruar me një punë të gjerë shkencore. Produktet shkencore të profesor Çelikut zënë mbi 150 zëra, që i kalojnë 4500 faqe, ku përfshihen monografi, vepra përgjithësuëse, studime, kapituj, artikuj, referate e kumtesa, dispensa dhe tekste universitare. Puna e tij shkencore është e njohur jo vetëm në vendin tonë por edhe ndërkombëtarisht. Ai ka qenë delegat në Kongresin e Drejtshkrimit si edhe ka marrë pjesë në konferenca e simpoziume shkencore lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare në Tiranë, Elbasan, Shkodër, Prishtinë, Tetovë, Sofje, Bukuresht etj. ku ka paraqitur arritjet e kërkimeve të tij shkencore, duke përfaqësuar denjësisht Universitetin e Elbasanit.

Ai ka përfaqësuar shtetin shqiptar dhe universitetin e Elbasanit në disa delegacione për shërbime jashtë vendit në ekipe universitare, shkencore, ministrore e parlamentare në Itali, Francë, Greqi, Rumani, Bullgari, Maqedoni, Gjermani, Angli, Danimarkë, Norvegji, Amerikë e Kosovë. Kontributi i tij në fushë të arsimit dhe kulturës shqiptare është shumë i gjerë.

Kontributi i tij shkencor shtrihet në disa fusha të ndryshme të gjuhësisë. Punën e nisi në *dialektologji* ku realizoi disa studime origjinale për kuantitetin e zanoreve në të folmet e shqipes, për rotacizmin në të folmet kalimtare, për gegërishten jugperëndimore, për togjet foljore si edhe skicë-monografitë për të folmen e Shtatit, të Dumresë, të Peqinit, të Kavajës, të Durrësit, të Ndroqit e Pezës dhe atë të Kerrabës.

E vazhdoi punën me kontribute të rëndësishme kryesisht të rrafshit teorik nga fusha e *morfologjisë*, ku botoi disa artikuj ku trajtohen probleme të rëndësishme të rrafshit teorik për rasat, nyjat, morfemën zero, format e pashtjelluara të foljes, gramatikalizimin e formave të caktuara foljore, për fjalëformimin e për parafjalët e shqipes. Puna e tij në këtë lëmë të gjuhësisë ka lënë gjurmë të rëndësishme në zgjidhjen e argumentuar shkencore të çështjeve problemore, si njoha e parafjalëve të rasës gjinore, mosnjohja e thirrores dhe vendores si rasi të veçanta, pranimi i rrjedhore vetëm në shumës të pashquar me *-sh*, njohja e nyjës joshquese *një/ca e disa*, realizimi i një klasifikimi strukturalist dhe të plotë të formave të pashtjelluara të foljes në tre kategori: gerund, përcjellore e pjesore, njohja e të ardhmes së sigurisë *kam për të bërë*, njohja e të tashmes e të pakryerës së vazhdimësisë *jam duke punuar-isha duke punuar*, mospranimi i mënyrës kushtore, paraqitja e një analize strukturore të

fjalës, njohja e disa parafjalëve foljore, emërore e përemërore dhe e disa lokucioneve parafjalore, si dhe klasifikimin strukturor të tyre.

Kontributi i tij në gramatikë përmbushet në fushën e *sintaksës* me studimin e togjeve foljore, fjalive të pagjymtyrëzueshme, fjalive njëkryegjymtyrëshe, gjymtyrëve të veçuara, fjalëve e togjeve të palidhura gramatikisht, fjalive të paplota, si edhe me qëndrimet e tij teorike për përbërësin sintaksor e për terminologjinë e sintaksës, ku spikat origjinaliteti dhe del në pah njohja tërësore e strukturës sintaksore të shqipes. Atij i takon merita e kalimit nga një qasje tradicionale në sintaksë drejt një qasjeje moderne, pa rënë pre e teorizimeve të tepërta, por duke gjetur zgjidhje të përshtatshme për analizën e shqipes. Disa nga prurjet e tij të rëndësishme në fushë të sintaksës janë: njohja e dy njësive sintaksore, përbërësit sintaksor e fjalisë dhe mosnjohja e periudhës si njësi e veçantë, klasifikimi strukturor i fjalive të përbëra, zgjerimin e kallëzuesit emëror dhe mosnjohja e përcaktorit kallëzuesor, njohja e trajtave të shkurtra të përemrave vetorë si caktuesorë të kalimtarësisë, shënjimi i përbërësve të fjalisë së përbërë me termin *sifjali* dhe vendosja e tyre në paralelizëm me gjymtyrët e fjalisë së thjeshtë.

Një kontribut të veçantë ka dhënë Çeliku për *shqipen standarde*, ku spikasin qëndrimet e tij të rëndësishme për normën morfologjike, për drejtshkrimin e shqipes, për përdorimin e shenjave të pikësimit, për shkrimin e emrave të përveçëm etj. Edhe pse gegë, ai është shprehur në shumë kumtesa e debate shkencore në mbështetje të shqipes standarde dhe ka dhënë kontributin e tij konkret në përmirësimin e saj. Që në krye të herës botoi disa artikuj ku diskuton për format *mësues-mësonjës*, *Koçoja –Koçua*, për emrat e vendeve në tabelat rrugore, trajtën e ndajshimit të paveçuar, si dhe një mori qëndrimesh për forma të caktuara gramatikore të fjalëve, parafjalëve e lidhëzave dhe shmangiet kryesore në sistemin emëror e foljor. Përdorimin e standardit dhe problemet në zbatimin e tij i ka ndjekur jo vetëm në Republikën e Shqipërisë por edhe në Kosovë e Maqedoni. Kontributin e tij për shqipen standarde e realizoi edhe nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në institucione të rëndësishme të vendosjes së saj siç ishte Kongresi i Drejtshkrimit, ku ishte delegat, dhe pjesëmarrja si anëtar i Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe.

Nuk janë të pakta kontributet e tij në *kulturë gjuhe* me artikuj për gjuhën shqipe në shkollë, institucionet kulturore, arsimore, shkencore kombëtare dhe për gjuhëtarët e shquar dhe figura të rëndësishme të kulturës sonë. Ai ka paraqitur vlerësimin e tij për kontributin shkencor të Kostandin Kristoforidhit, Aleksandër Xhuvanit, Simon Shuteriqit, Kostaq Cipos, Mahir Domit, Lirak Dodbibës, Remzi Përnaskës, Spiro Floqit etj. si dhe për rëndësinë e institucioneve kulturore e arsimore kombëtare si Kongresi i Manastirit, Kongresi i Elbasanit, Shkolla Normale, Komisia Letrare e Shkodrës, Konsulta e Prishtinës e Kongresi i Drejtshkrimit.

Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe kontributin e tij në *leksikologji* me gjurmimin e fjalëve të reja, fjalëve të huaja në shqipe dhe me kritikën leksikografike për fjalorët e shqipes. Në kritikën leksikografike që realizon për ‘Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe’, 1980, dhe ‘Fjalorin e shqipes së sotme’, 2002, ai përmend një numër të madh fjalësh të gjurmëuara prej tij në median e shkruar dhe atë të folur të cilat nuk përfshihen në fjalor, por që janë bërë pjesë e përdorimit të përditshëm të gjuhës.

Në çdo fushë të veprimtarisë së tij shkencore ai do të kujtohet për kontribut origjinal, për arritje të rëndësishme të dala nga studimi i një materiali të pasur gjuhësor, nga njohja e thellë e gjuhës së folur dhe të shkruar.

Me rastin e 80 vjetorit të tij, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” organizoi konferencën mbarëkombëtare “Mehmet Çeliku- Personalitet i gjuhësisë shqiptare” ku morën pjesë studiues nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi, të cilët në kumtesat e tyre kanë vlerësuar kontributin e shumanshëm të prof. Mehmet Çelikut. Kumtesat janë botuar në përmbledhjen me të njëjtin titull më 2016.

Ai nuk e ndali për asnjë çast veprimtarinë e tij shkencore. Gjatë 2020-ës përfundoi dhe çoi në shtyp veprën “*Gegërishtja Jugperëndimore*”, e cila përmban disertacionin për marrjen e gradës “Kandidat i shkencave” dhe dhjetë artikuj nga fusha e dialektologjisë dhe po punonte për botimin e veprës së dytë nga fusha e dialektologjisë “*Të folme kalimtare të shqipes dhe të folme të gegërishtes jugperëndimore*”, ku përfshihen skicë-monografite e hartuara për të folmet e Dumresë, Shpatit, Peqinit, Kavajës, Durrësit, Kërrabës dhe Ndroqit e Pezës, kjo e fundit publikohet për herë të parë. Të dy vëllimet janë botuar nga Akademia e Studimeve Albanologjike. Po gjatë kësaj kohe përgatiti botimin e pestë të veprës “*Gramatika praktike e gjuhës shqipe*” të cilën e plotësoi me disa shënime të karakterit teorik dhe e përditësoi në terminologji, botim të cilin mendonte ta realizonte më vonë. Në planet e tij të afërta ishte edhe botimi i një vëllimi me kritikë shkencore, punë të cilën e kishte nisur me shënimet që mbante për veprat dhe artikujt që lexonte.

Ai mund të quhet pa mëdyshje shkencëtar dhe intelektual i vërtetë. Gjatë gjithë jetës nuk rreshti së menduari për Universitetin dhe për shkencën. Edhe pse në pension, ai në çdo bisedë shqetësohej për të ardhmen e universitetit, për politikën arsimore dhe për mundësitë e zhvillimit të tij; për ardhmërinë e departamentit të cilin e ndërtoi vetë dhe, me modelin e tij, e bëri një bërthamë të rëndësishme të kërkimit shkencor, të dallueshme në të gjithë vendin.

Profesori, për gjithë ata që patën nderin ta njohin nga afër e ta kenë bashkëpunëtor do të mbetet shkencëtari model i punës dhe i vullnetit të çeliktë. Fizikisht ai nuk është më midis nesh, por emri dhe vepra e tij do të mbeten përjetësisht midis të gjallëve.

Resul Telhaj